

20252474795

**LIGJ I SHNDËRRIMIT TË KËRKESAVE TË REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT,
BAZUAR NË DETYRIMET PUBLIKE, NË DEPOZITË TË PËRHERSHME NË
NDËRMARRJEN PUBLIKE PËR MENAXHIMIN E OBJEKTEVE SPORTIVE NË
PRONËSI TË REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT - SHKUP**

Neni 1

Ky Ligj rregullon mënyrën, procedurën dhe kushtet për shndërrimin e kërkesave të Republikës së Maqedonisë së Veriut, bazuar në detyrimet publike, në depozitë të përhershme në Ndërmarrjen Publike për Menaxhimin e Objekteve Sportive në Pronësi të Republikës së Maqedonisë së Veriut – Shkup.

Neni 2

(1) Kërkesat e Republikës së Maqedonisë së Veriut bazuar në detyrime publike nga Ndërmarrja Publike për Menaxhimin e Objekteve Sportive në Pronësi të Republikës së Maqedonisë së Veriut – Shkup, sipas kuptimit të këtij ligji janë kërkesat bazuar në kontributet për sigurimin e detyrueshëm pensional dhe invalidor, kontributet për sigurimin e detyrueshëm shëndetësor, sigurimin në rast lëndimi në punë dhe sëmundjeje profesionale, si dhe kontributin e detyrueshëm për sigurim në rast papunësie dhe tatimit mbi të ardhurat personale.

(2) Interesi (kamata) dhe kërkesat bazuar në kontributet për sigurimin e detyrueshëm pensional dhe invalidor, kontributet për sigurimin e detyrueshëm shëndetësor, sigurimin në rast lëndimi në punë dhe sëmundjeje profesionale, si dhe kontributin e detyrueshëm për sigurim në rast papunësie dhe tatimit mbi të ardhurat personale nga paragrafi (1) i këtij neni, do të përlllogariten nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

(3) Shuma e borxhit kryesor dhe e kamatës në paragrafët (1) dhe (2) të këtij neni, përcaktohen me procesverbal nga përfaqësuesit e organeve të administratës shtetërore ose organit apo institucionit tjetër kompetent që mban evidencë për përcaktimin dhe arkëtimin e detyrimit publik, si dhe nga përfaqësuesit e Ndërmarrjes Publike për Menaxhimin e Objekteve Sportive në Pronësi të Republikës së Maqedonisë së Veriut - Shkup .

Neni 3

(1) Të gjitha organet dhe institucionet shtetërore, kërkesat e të cilave shndërrohen në depozitë të përhershme në Ndërmarrjen Publike për Menaxhimin e Objekteve Sportive në Pronësi të Republikës së Maqedonisë - Shkup, si kontribute për sigurimin e detyrueshëm pensional dhe invalidor, kontribute për sigurimin e detyrueshëm shëndetësor, sigurimin në rast lëndimi në punë dhe sëmundjeje profesionale, si dhe kontributin e detyrueshëm për sigurim në rast papunësie dhe tatimit mbi të ardhurat personale, ia bartin Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut pa kompensim.

(2) Ndërmjet organeve dhe institucioneve shtetërore, kërkesat e të cilave shndërrohen në depozitë të përhershme në Ndërmarrjen Publike për Menaxhimin e Objekteve Sportive në Pronësi të Republikës së Maqedonisë – Shkup, lidhen marrëveshje për bartjen e kërkesave.

Neni 4

(1) Procedura për shndërrimin e kërkesave të Republikës së Maqedonisë së Veriut bazuar në depozitë të përhershme në Ndërmarrjen Publike për Menaxhimin e Objekteve Sportive në Pronësi të Republikës së Maqedonisë-Shkup kryhet me regjistrimin e shumës së depozitës së përhershme në Ndërmarrjen Publike për Menaxhimin e Objekteve Sportive në Pronësi të Republikës së Maqedonisë-Shkup, në Regjistrin Qendror të Republikës së Maqedonisë së Veriut.

(2) Me përjashtim të paragrafit (1) nga ky nen, procedura për shndërrim të kërkesave të Republikës së Maqedonisë së Veriut, për shumën e depozitës së përhershme në Ndërmarrjen Publike për Menaxhimin e Objekteve Sportive në Pronësi të Republikës së Maqedonisë-Shkup, në bazë të kontributit për sigurim pensional dhe invalidor, kryhet deri në ditën e pagesës së shumës së mbetur borxh të Ndërmarrjes Publike për Menaxhimin e Objekteve Sportive në Pronësi të Republikës së Maqedonisë-Shkup ndaj Fondit të Sigurimit Pensional dhe Invalidor të Maqedonisë së Veriut, nga ana e Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Neni 5

(1) Pas regjistrimit të depozitës së përhershme të Ndërmarrjes Publike për Menaxhimin e Objekteve Sportive në Pronësi të Republikës së Maqedonisë së Veriut-Shkup në Regjistrin Qendror të Republikës së Maqedonisë së Veriut, pushojnë detyrimet juridike të Ndërmarrjes Publike për Menaxhimin e Objekteve Sportive në Pronësi të Republikës së Maqedonisë-Shkup në bazë të borxhit kryesor, kamatës dhe kërkesave të tjera dytësore në përputhje me nenin 2, paragrafi (1) dhe (2) të këtij ligji.

(2) Pas kryerjes së regjistrimit të depozitës së përhershme të Ndërmarrjes Publike për Menaxhimin e Objekteve Sportive në Pronësi të Republikës së Maqedonisë së Veriut-Shkup, Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut do t'i njoftojë për të njëjtën organet e administratës shtetërore dhe institucionet të cilat mbajnë evidencë për kërkesat të cilat shndërrohen në depozitë të përhershme në Ndërmarrjen Publike për Menaxhimin e Objekteve Sportive në Pronësi të Republikës së Maqedonisë-Shkup, me qëllim që organet dhe institucionet shtetërore të zbatojnë shndërrimin në depozitë të përhershme në evidencat e tyre, në përputhje me ligjet.

Neni 6

Shndërrimi i kërkesave të Republikës së Maqedonisë së Veriut në depozitë të përhershme në Ndërmarrjen Publike për Menaxhimin e Objekteve Sportive në Pronësi të Republikës së Maqedonisë-Shkup, mbi asnjë bazë juridike, nuk mund të jetë në dëm të kërkesave të palëve të treta që ato i kanë ndaj Ndërmarrjes Publike për Menaxhimin e Objekteve Sportive në Pronësi të Republikës së Maqedonisë-Shkup.

Neni 7

Ky ligj hyn në fuqi në ditën e tetë nga dita e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut.